



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
POGRADEC

VENDIM

Nr. 57, DATË 12/10/2016

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 9, DATË 10.2.2016 "MBI
MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE"**

Në mbështetje të gërmës "b", pikës 1.3 te nenit 9, të gërmës "a" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 35, të gërmës "f" të nenit 54 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të VKM nr 608, datë 5.9.2012, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre , kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", i ndryshuar me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli i Bashkisë :

VENDOSI:

1. Në kapitullin II "Tarifat Vendore" të vendimit të Këshillit të Bashkisë nr 9, datë 10.2.2013 "Mbi miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore", të shtohet pika II.16/1 dhe pika II.19/1, me këtë përmbajtje:

**II.16 /1 TARIFA TË NJËSISË EKONOMIKE TË QENDRES KULTURORE
Te shtohet**

| Kategoria | Njesia | Vlera |
|--|-----------------|-------|
| Kurse artistike | Lek/muaj | 500 |
| Dhenie me qera kostumet popullore jo autentike | Lek/cifti/event | 2,500 |

**II.19/1 : TARIFA APLIKIMI PER KALIM PRONESIE TE NDERTESAVE TE
NDERTUARA PARA DT.10.8.1991.**

| Kategoria | Njësia | Vlera |
|--|--------|-------|
| Tarifë aplikimi për ndërtesa të ndërtuara para datës 10.8.1991 në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec | lekë | 5,000 |

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Juridike, Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare .

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Natalja Velo

